



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Suharekës

31 Dhjetor 2010

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorëve të Pavarur	1
General	6
Të gjeturat për vitin aktual	7
Gjetjet e vitit të kaluar	15
Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Raportin e Auditimit për vitin 2010	21
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2010	24
Politikat Kontabël	28

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000
Pristina
Kosovo
T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Kryetarin e Komunës Suharekë, Kosovë

Raporti i Pasqyrave Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Komunës së Suharekës (“Komuna”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (“SNKSP”) Bazuar në Paranë e Gatshme *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/ 2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave të Buxhetit dhe Udhëzimeve Administrative No. 15/2009, 18/2009 dhe 21/2009., dhe për atë kontroll të brendshëm menaxhmenti përcakton nevojshmërinë për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Gjatë bërjes së vlerësimit të riskut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve

kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazë për mendimin tonë të kualifikuar të auditimit.

Bazat për Opinion të Kualifikuar

1. Komuna nuk ka mbajtur lista të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operacionale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontroleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010.
2. Disa shpalosje të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Udhëzimi Administrativ nr 2010/16 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk janë bërë nga ana e Komunës në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010. Në veçanti, çështjet në vijim janë lënë jashtë ose shpalosur në mënyrë të gabuar në pasqyrat financiare:
 - Sqarimi i diferencave materiale ndërmjet shumave të buxhetuara dhe aktuale nga shënimet 17-23. Shpalosja për diferencën materiale në shumë prej 781 mijë euro në notën 23, daljet tjera nga llogarit e thesarit nuk është shpalosur dhe sqaruar për diferenca materiale.
 - Tabela e daljeve të parasë së gatshme, seksioni 10. Raporti i ekzekutimit të buxhetit nga shënimet 19-23 nuk është prezentuar siç duhet sipas figurave të daljeve të parasë së gatshme nga thesari. Harmonizimi ndërmjet ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit. Shënimi i prezantuar nuk është shpalosur siç duhet.
 - Llogaritë e arkëtueshme të raportuara në shënimin 28 nuk janë të mbështetura me dokumente mbështetëse të besueshme dhe të plota, si: tatimi në pronë, licencat për biznese dhe taksat e lejeve të punës.

Për shkak të çështjeve të shpalosura më lartë, ne nuk ishim në gjendje për të marrë siguri të arsyeshme për saktësinë e të dhënave financiare në lidhje me asetet fikse si dhe llogarit e arkëtueshme të Komunës të cilat janë shpalosur në pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2010.

Opinion i Kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të shpalosura në paragrafin “Bazat për Opinion të Kualifikuar”, pasqyrat financiare të Komunës paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, fakturat e parasë së gatshme të sajë dhe pagesat dhe ekzekutimin e buxhetit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik “Raportimi Financiar Sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme” dhe me

Intruksionin Administrativ Nr. 16/2010 për Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe Instrukcionin Administrativ Nr. 15/2009, 18/2009 dhe 21/2009.

Theksim i çështjes

Ne i kushtojmë vëmendje çështjeve në vijim:

Komuna mban regjistër të veçantë me të dhënat financiare për pasuritë e saj fikse. Megjithatë, bazuar në ekzaminimin tonë, ne kemi gjetur se të dhënat lidhur me pasqyrat financiare të komunës deri më 31 Dhjetor 2010 nuk janë harmonizuar me ato prej pasurisë fikse në regjistrin i cili mbahet në sistemin informativ të menaxhimit financiar në Kosovë (SIMFK). Kjo është për shkak të faktit se Thesari ka aplikuar zhvlerësimin në përputhje me metodat e amortizimit, por komuna nuk ka aplikuar metodën e zhvlerësimit në regjistrin e tij dhe kjo nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzime administrative No.21/2009 mbi Menaxhimin e pronës së qeverisë, neni 4, seksioni 6 (prej 6.1 – 6.14)

Raport mbi kërkesat e tjera Ligjore dhe Rregullative

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse ne të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Auditorëve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jone është kryer në përputhje me ISSA1 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep me pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tone në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një baze për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë auditimit, janë në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- a) Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Komuna ka realizuar një program të brendshëm të integruar të kontabilitetit që do të sigurojë me kohë, informacion të plotë dhe të saktë për qëllime raportimi, por ky softuer i kontabilitetit nuk është i përshtatshëm për qëllim të pagesave të palëve të treta, regjistrimin e aseteve fikse edhe për sigurimin e informacionit në lidhje me faturat e papaguara (detyrimeve).
- b) Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës.
- c) Ne identifikua një numër jo përputhshmërisht me Ligjin Nr 02/L-99, i shpallur me Rregulloren Nr.2007/20 e cila është derivatit nga Rregullorja 2003/17 e prokurimit "Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë" (i ndryshuar). Të tilla jo-pajtueshmëri kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit të kërkuara të cilat nuk janë kryer dhe nuk janë dokumentuar nga Komuna.
- d) Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundur që pagesa të parasë së gatshme të kërkohen ne te ardhmen e afërt, Komuna nuk ka kryer ndonjë proces zyrtar që mund të sigurojë informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.

Grant Thornton

Prishtina,

11 Mars 2011

Shtojca I

Letër menaxhmenti

General

Auditimi për 2010

Grant Thornton LLC është emëruar të bëjë auditimin e pasqyrave financiare të Komunës Suharekë (“Komuna”) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010 të përgatitura mbi Bazat e Parasë së Gatshme në përputhshmëri me SNKSP të Raportimit Financiar mbi Bazat e Kontabilitetit të Parasë së Gatshme.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuar në vazhdim dhe bazohet në plotësinë dhe saktësinë e fakteve, supozimeve dhe prezantimeve të paraqitura më poshtë. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht e plotë ose e saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qenë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne mbështetemi në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/ose prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të rifreskojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

Pasoja

Raporti ynë është planifikuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime. Është detyrimi juaj të ndërmerri veprimet e nevojshme për korrigjimin e dobësive dhe në qoftë se ju dështoni në të, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

Përfundimi i masës

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësishme në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët, përveç në rastin e neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesisë së paramenduar, nuk do na mbani ne përgjegjës ose të detyruar për çfarëdo humbje ose pasoja të tjera nëse materiali i informacionit i punës sonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

Struktura e këtij raporti

Çdo kategori e vëzhgimeve është përshkruar në një faqe të veçantë. Për secilin vëzhgim struktura është: të gjeturat, risku, rekomandimi dhe përgjigja e Menaxhmentit.

Të gjeturat për vitin aktual

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Burimi parësor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Edhe pse Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në një program (softueri) me bazë në Access ,por edhe në SIMFK, ky sistem nuk përdoret për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Deklarata lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare ishte nënshkruar dhe komuna kishte përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhën shqipe ,serbe dhe gjuhën angleze. Përveç kësaj, informacioni i mëposhtëm i cili është i nevojshëm për tu shpalosur në pasqyrat financiare nuk është regjistruar në SIMFKdhe nuk është pjesë e një programi kontabiliteti të integruar:

- Prona Pajisjet dhe Impiantet ,
- Llogaritë e arkëtueshme,
- Llogarit e pagueshme ,
- Detyrimet kontingjente, dhe
- Pagesat nga palët e treta
-

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente

Si rrjedhojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Llogaritë e arkëtueshme të raportuara në pasqyra financiare, shënimi 28 nuk janë mbështetur me dokumente adekuate mbështetëse (nuk ka listë të përshtatshme të llogarive të arkëtueshme të përgatitur në fund të vitit 2010) licencat e biznesit, lejet e punës dhe tatimet në prone. Gjithashtu, në listën e llogarive të arkëtueshme ne kemi identifikuar disa vlera ta balancave negative të cilat duheshin eliminuar nga lista .
- Neni 10 Raporti i ekzekutimit të buxhetit. Shuma e prezantuar në kolonën finale të buxhetit në raporte nuk mund të lidhet me shumat e buxhetit sipas SIMFK-së për shumën prej 70 mijë euro.
- Neni 9, pagesat nga palët e treta, Komuna ka përfshire vetëm palët të cilat kanë participuar në financim bashkë me komunën. Nuk ka informata në lidhje me palët tjera që kanë financuar si asete jo-financiare.
- Neni 9 nuk është në harmonizim me nenin 10. Shtesë: Pasqyrat financiare të pranimeve të

31 Ddhjetor 2010

pagesave nga palët e treta.

- Neni 10 Raporti i ekzekutimit të buxhetit për shpalosjen 11 Grantet e përgjithshme nuk janë prezantuar siç duhet në pasqyra financiare pasi që nuk janë prezantuar si shpalosje tek shënimi 11 ose në shënimin tjetër , në vend se të shpaloset se çfarë në realitet prezantohet në grantin kryesor.

-

Risku

Dobësitë në kontrollet e brendshme lidhur me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe keq pohimet lidhur me sa vijon:

- Plotësinë dhe saktësinë e informatave financiare;
- Integritetin e të dhënave;
- Mbrojtjen e Aseteve dhe;
- Mos-regjistrimin e pagesave nga palët e treta mund të rezultojnë në mjete / shërbime të tilla duke u përdorur me pa qira nga palët e tjera prej Komunës.

Rekomandim

Përgatitja e pasqyrave financiare te Komunës duhet të përfshij procedure dhe metoda të cilat janë dizenuar për të siguruar qe informacioni i kërkuar të jetë regjistruar, procesuar dhe përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare

Komentet e Menaxhmentit

-Llogaritë e arkëtueshme evidentohen po ashtu ne mënyrë profesionale dhe mbështetet me dokumentacion te përshtatshëm te cilat dëshmi ia kemi ofruar auditorët

Shtojce :Regjistri i te arkëtueshmeve te tatimit ne prone te të hyrave nga taksa komunale dhe qiratë.

-Shuma prej 70 është tejkallim i të hyrave vetanake dhe është evidentuar në SIMFK si e hyrë vetanake dhe si e tillë nuk është bartur në raportin e analizave të SIMFK-së nga ana e thesarit dhe kjo e gjetur duhet të i adresohet Thesarit. Komuna me kohë ka marrë Vendim mbi tejkallimin e planifikimit të të hyrave vetanake dhe menjëherë e ka dërguar për procesim ne SIMFK

Shtojcë:Vendimi për tejkallimin e të hyrave vetanake, raporti i SIMFK-se raporti i barazimeve me thesarin

-Pagesat nga palët e treta ku komuna ka qen përfituese por jo me para te gatshme i kemi paraqitur përkatësisht shpalosur në pasqyrat financiare dhe komuna e Suharekës nuk është në dijeni se ka ndonjë pagesë tjetër nga palët e treta, poqese auditori ka ndonjë informacionet tjetër këtë të gjetur do ta pranojmë në tërësi. Me përgjegjësi të plotë deklarojmë se komuna nuk ka përfitime tjera nga palët e treta .

Shpjegim për vlerën prej 781 të theksuar në draft raport .Vlera si e tillë nuk është diferencë por janë mjetet e bartura nga viti 2010 për projektet e caktuara që do të realizohen në vitin 2011 dhe atë 683 janë mjete vetanake te bartura ne vitin 2011 dhe vlera prej 98 janë mjete nga grandit qeveritar ne total 781

Shtojce :Regjistri i projekteve kapitale te bartura nga vitit 2010 ne vitin 2011 ne total 683 ndërsa pjesa tjetër përkatësisht vlera prej 98 janë mjete buxhetore nga fondi burimor 10

2 Menaxhimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve

Të gjeturat

Komuna mban regjistër të veçantë me të dhënat financiare për pasuritë e saj fikse. Megjithatë, bazuar në ekzaminimin tonë, ne kemi gjetur se të dhënat lidhur me pasqyrat financiare të Komunës deri më 31 Dhjetor 2010 nuk janë rakorduar me ato prej regjistrit kontabël si dhe rexhistrin të asetëve fikse i cili mbahet në sistemin informativ të menaxhimit financiar në Kosovë (SIMFK) dhe nga ana e vet klientit. Kjo është për shkak të faktit se për shkak se Thesari ka aplikuar zhvlerësimin në përputhje me metodat e amortizimit, por komuna nuk ka aplikuar zhvlerësimin në regjistrin e saj kjo nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit administrativ Nr.21/2009 mbi Menaxhimin e pronës së qeverisë neni 4 pika 6.1-6.14.

Për më tepër, Komuna ka vlerësuar artikujt e asetëve e saj, ndërtesat dhe pajisjet me vlerën e drejt, në bazë të vlerësimit të kryer gjatë vitit 2009. Vlerësimi është bërë nga një komision i themeluar nga brenda. Komisioni nuk është përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë mbështetur nga ndonjë raport me të dhëna burimore mbi vlerësimin.

Regjistri i asetëve fikse paraqet vetëm pasurinë mbi vlerën Euro 1,000, pa ndonjë paraqitje ose shpjegim në lidhje me vlerën e asetëve nën vlerën 1000 Euro. Numërimi dhe verifikimi fizik i pasurisë ,pronës dhe impianteve në fund të vitit 31 dhjetor 2010, është bërë nga komisioni për rexhistrim për pasuri, por jo i përfunduar për të gjitha departamentet (dmth. Departamenti i administratës). Së fundi, asnjë raport përmbljedhës nuk është përgatitur në lidhje me harmonizimin e vlerës së asetëve sipas numërimit të pasurisë dhe vlerës kontabël siç është raportuar në regjistrin e asetëve fikse.

Komuna nuk e ka miratuar zyrtarisht udhëzimin e inventarit i cili është kërkuar nga Udhëzimi Administrativ nr. 21/2009.

Për më tepër, Komuna ka vlerësuar artikujt të pronës, objekteve dhe pajisjeve me vlerat e tyre të drejta, të përcaktuara në bazë të vlerësimit të kryer gjatë vitit 2010. Vlerësimi është kryer nga një komision i themeluar brenda. Komisioni nuk është i përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura me ndonjë raport të vlerësimit.

Për shkak të çështjeve të diskutuara më lartë, ne nuk ishim në gjendje për të marrë siguri të arsyeshme për saktësinë e të dhënave financiare në lidhje me asetet fikse të Komunës të shpalosura në pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2010.

Risku

Mos ekzistenca e procedurave dhe politikave të regjistrin adekuat mund të shpie tek trajtimi jo adekuat i asetëve në sajë të kufizimeve të pandara të kontrollit të ambientit.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë Komunën e Suharekës të zhvilloj dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet. Përveç kësaj dhe si minimum, për regjistrin të lartpërmendur duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për çdo pasuri fikse:

- Datën e përvetësimit
- Vendndodhjen
- Numër i specifikuar nga komuna (numër identifikues)
- Numër serik

31 Ddhjetor 2010

- Përshkrimi dhe funksioni
- Kosto
- Detajet e zhvlerësimit, duke përfshirë metodat e llogaritjes si për qëllime të taksave edhe financiare për qëllime të raportimit
- Jeta e dobishme e parashikuar
- Koston e mirëmbajtjes pas datës së përvetësimit
- Data e nxjerrjes jashtë përdorimit
- Burimi i Financimit
- Numri i faturës së për shpenzimin e bërë

Komentet e Menaxhmentit

Komuna e Suharekës mban ne mënyrë profesionale regjistrin e asetëve fikse dhe për çdo vit zyrtari për menaxhimin e pasurive bene edhe zhvlerësimin e asetëve fikse dhe informacionet e asetëve fikse te mirëmbajtura nga ana e zyrtarit për[puthen ne tersi me informacionet e Thesarit.

Komuna po ashtu ne mënyrë profesionale mbanë edhe regjistrin e pasurive ne te cilin regjistër evidentohet e tërë pasuria e komunës dhe veçmas për Arsim, QKMF administrata dhe asetet në total për Komunën. Komisioni i formuar nga ana e komunës për njësimin e asetëve ka bërë regjistrimin e asetëve fikse dhe punën e ka përfunduar gjatë kohës sa ishte ne auditim. Informacionet për regjistrimin e asetëve dhe regjistrin veçmas dhe sa bashku ne total ne mënyrë elektronike dhe fizike ia kemi ofruar auditorit.

Për një progres te shtuar ne menaxhimin e asetëve është konstatuar edhe nga auditivi i bërë për periudhën qe përfundon me 31.09.2010

Komuna gjitha ashtu mban regjistër ne mënyrë profesionale ku janë te regjistruar te asetet edhe ne vlere nen 1000 €

-Komuna ka bere shpalosjet te drejte ne Pasqyrat financiar si Totalin e koston historike te asetëve zhvlerësimin e akumuluar dhe vlerën neto në libra te asetëve, komuna ka angazhuar një program ne te cilin evidentohen të gjitha asetet pas pranimit te mallit zyrtari i pranimit te gjitha asetet e blera i identifikon me vendndodhjen, numërimin fizik dhe identifikon edhe me barkod.

Shtojce regjistri i asetëve fikse në total për komunën regjistrimet e asetëve nga ana e komisionerve përinventarizim.,

3 Të Hyrat

Të gjeturat

Një sistem i automatizuar faturimit ekziston vetëm për tatimin mbi pronën. Me përjashtim të të ardhurave nga licenca e biznesit i cili është mbajtur në regjistrimet në Access, faturimi i Komunës është regjistruar në një sistem jo të automatizuar të faturimit

31 Dhjetor 2010

Në të hyrat prej taksave në biznese, ne kemi vërejtur disa njësi me balanca negative dhe disa me emra të paidentifikuar të taksa paguesve. Komuna i ka shënuar ata taksa pagues të paidentifikuar në sistemin FMISK si pagesë e panjohur.

Thesari ka nuk ka regjistruar kërkesën e Komunës për alokimin e të hyrave vetanake, të cilat janë mbledhë më shumë se që janë planifikuar në shume prej 70 mijë euro.

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar diferenca në të hyrat e njohura në fre balanc dhe sistemin e brendshëm të kontabilitetit për kodin ekonomik nr. 50019 taksa të tjera administrative dhe kodin ekonomik nr. 50018 taksa për fotokopjimin e dokumenteve. Kështu që ne kemi identifikuar që nuk ka pasur klasifikim adekuat ndërmjet këtyre dy kodeve ekonomike në shumë prej Euro 2,422.

Risku

Përderisa të arkëtueshmet janë kërkuar të shpalosen në pasqyrat financiare por nuk janë shpalosur, mungesa e saktësisë dhe tërësisë do të ndikojnë në të hyrat që Komuna mund të fitojë. Kontrollat e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe papërshtatshmëria softuerike dhe sistemi i faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të informacionit. Dobësitë e tilla të sistemit mund të çojnë në faturim jo të plotë dhe të ardhura jo të plota. Regjistrimi manual dhe mungesa e ndërhyrjes së faturimit dhe sistemi i kontabilitetit ekspozon Komunën për rrezikun shtesë të gabimeve. Përveç kësaj, ajo mund të jetë konsumim i kohës dhe mund të krijojë shpenzime shtesë për regjistrin e të dhënave, rishikimin dhe harmonizimin e informacionit.

Rekomandim

Ne rekomandojmë që Komuna të përmbaj regjistër të ndarë të debitorëve të saj. Ky informacion mund të përmirësonte dukshëm menaxhimin e të hyrave gjatë Procesit të buxhetimit dhe mbledhjes së aseteve. Menaxhmenti gjithashtu do të përfitonte duke zbatuar procesin e faturimit dhe mbledhjes së informacionit në baza të kohës reale. Lista e detajuar dhe e rifreskuar e tatimpaguesve individual, bizneseve aktive dhe debitorëve të nxjerrur nga sistemi është e rëndësishme sidomos në situatën aktuale ku komunat nuk regjistrojnë secilin transaksion individual në Free Balance.

Gjithashtu Komuna duhet ti kushtojë rëndësi klasifikimit të transaksioneve financiare në regjistrimin ditor të shpenzimeve.

Komentet e Menaxhmentit

-Komuna lidhur me përcaktimin e detyrimeve nga lejet biznesore ka një program në Access dhe të gjitha informacionet e ngarkesave dhe inkasimeve ruhen edhe në serverin e komunës. Ky konstatim është vërtetuar dhe konstatuar edhe në auditimin e ushtruar nga ana e auditorëve ku konfirmohet se për ngarkesat, inkasimet dhe llogarit e arkëtueshme komuna ka shënuar një progres të shtuar për të hyrat nga lejet biznesore, qiratë e ndryshme.

-Komuna ka të regjistruar një numër të konsiderueshëm të bizneseve të cilat nuk zhvillojnë kurrfarë aktiviteti biznesor. Komisioni gjatë verifikimeve në teren dhe duke shqyrtuar ankesat e një subjekti afarist ka verifikuar dhe konstatuar se disa biznese nuk ushtrojnë kurrfarë aktiviteti biznesor dhe u ka shlyer detyrimet konform rregullores së miratuar nga komuna dhe është e justifikueshme se një apo disa biznese janë në parapagim. Komuna sipas kërkesave i përgatit procedurat për kthimin e mjeteve për disa detyrues të cilët janë në parapagim

-Për të gjeturën e tretë për të hyrat nga grandit komentit e kemi shpalosur ma larte si dhe për tejkalimin e të hyrave vetanake,

4 Shpenzimet

Gjetjet

Bazuar në ekzaminimin tonë të dëshmimeve burimore për fatura dhe pagesa për mjekime dhe printime të materialit ne kemi gjetur disa raste ku shënimet e faturave të mallrave nuk janë nënshkruar nga personi që i ka pranuar ato në drejtorinë e Shëndetësisë – kujdesi primar.

Pas përfundimit të punës sonë tek klienti ne u takuam për herë të dytë me datën 26.04.2011 dhe gjetëm se fletëpranimi ishte e nënshkruar kopje e dokumentit por nuk kishin mundësi përgjegjës të na ofrojnë edhe dokumentin komplet nga origjinali të CPO-së me qëllim të verifikimit të dokumentit burimor.

Risku

Zbatimi jo i duhur i kontroleve të themeluara mund të shpie deri te keqpërdorimi i asetëve të Komunës dhe mund të ketë ndikim negativ në kompletimin dhe përpikërinë e informacionit financiar të Komunës.

Rekomandim

Ne këshillojmë komunën që në mënyrë strikte të zbatojë kontrollet e krijuara p.sh. gjithë dokumentacionin burimor lidhur me faturat e mallrave do duhej autorizuar nga personi që ka pranuar mallrat.

Komentet e Menaxhmentit

Mostrat e ekzaminuara nga ana e auditorit janë të kompletuara në pajtueshmëri me rregullin financiar nr. 02 mars të vitit 2009 dhe në origjinal të dosjeve ekzistojnë të gjitha nënshkrimet e autorizuesve dhe zyrtarit për pranim, këtë ia kemi dokumentuar edhe auditorit me raportet e pranimit në Original. I gjithë dokumentacioni ne origjinal ruhet dhe arkivohet në thesar për deri sa dokumentacioni tjetër fotokopjet ruhen nga programet buxhetore dhe gjatë fotokopjimeve ka mundësi që mos të shikohet ndonjë nënshkrim eventual.

Ju bëjmë me dije se asnjë pagesë nuk mundet të autorizohet dhe certifikohet për deri sa dosja në origjinal nuk është e kompletuar dhe e konfirmuar nga autorizueset dhe zyrtari i pranimit.

Shtojcë dokumentacioni i pagesave përkatësisht raportet e pranimit të nënshkruara nga zyrtari i pranimit

3. Prokurimi

Gjetjet

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor lidhur me procedurën tenderuese të zbatuar për ndërtimin e rrugës, furnizimit me karburante, ndërtimi i shkollave etj., ne kemi identifikuar disa parregullsi.

Domethënë, në ndërtimin e rrugës në fshatin Sopije me numër identifikues nr. 624 10 004 521 është bërë një vonesë në përfundimin e punës, dhe Komuna nuk ka marrë informacione lidhur me vonimin.

31 Ddhjetor 2010

Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar dënime siç është parashikuar në marrëveshjen kontratë në rast se puna nuk përfundohet me kohë. Për më tepër ekzekutimi i garancisë së punëve ka qenë i vlefshëm deri më 01 Maj 2010 përderisa projekti ka përfunduar më 23 Korrik 2010. Në gjithashtu kemi identifikuar që Komuna nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 39 të PPL sipas të cilit Komuna është e obliguar të publikojë në gazetë ditore emrin e ofertuesit të zgjedhur përbrenda dy ditëve biznesore kur është marrë vendimi.

Për më tepër, në ndërtimin e rrugës në fshatin Duhel, rruga “Lagja e Sopeve” – faza II me numër identifikues 624 10 005 521 ishte një vonesë dy mujore për përfundimin e punës, dhe Komuna marrë kurrfarë informacioni lidhur me vonesën. Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar dënime siç është parashikuar në marrëveshjen kontratë në rast se puna nuk përfundohet në kohë.

Për më tepër, në ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Mushetisht-Baqevc me numër identifikues 624 10 009 521 ka qenë një vonesë tre mujore në përfundimin e punës, dhe Komuna nuk ka pranuar ndonjë informacion për vonesën. Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar dënime siç është parashikuar në marrëveshjen kontratë në rast të mos përfundimit të punëve me kohë. Për më tepër, ekzekutimi i garancisë së punëve ka qenë i vlefshëm deri më 18 Qershor 2010 përderisa projekti është përfunduar më 09 Gusht 2010.

Veç kësaj, në ndërtimin e shkollës në fshatin Shiroka me numër identifikues 624 10 015 521 është bërë një vonesë dy mujore në përfundimin e punës, dhe Komuna nuk ka marrë asnjë informacion për vonesën. Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar dënimet siç është parashikuar në marrëveshjen kontratë në rast se puna nuk përfundohet në kohë.

Komuna e Suharekës ka kontratë për furnizim me karburante me numër identifikues 624-08-107-.121 që ka skaduar më 28 Janar 2010. Sidoqoftë, kontraktuesi ka vazhduar t'i dërgojë karburante Komunës deri më 06 Tetor 2010, kur është zgjedhur përsëri.

Për më tepër, në ndërtimin e shtresës së lumit Toplluha-faza e II me ID nr. 624 10 052 521 për shumën prej 231,000 Euro ishte paguar kontraktuesit në shumën totale të kontratës pa pranimin teknik të punëve mbaruar. Gjithashtu, nuk kishte asnjë informacion lidhur me arsyen për vonesën e punës. Në kemi vërejtur se kontraktori ende nuk e ka filluar ndërtimin dhe në bazë të termave të kontratës të projektit duhet të ketë përfunduar brenda 40 ditë pune ose 2010/11/25. Nuk ka raport vlerësimi është bërë nga menaxheri i projektit ose personi tjetër përgjegjës gjatë vitit 2010.

Komuna nuk ka marrë njoftim me shkrim për vonesën dhe gjithashtu nuk zbatohen ndëshkimet ashtu siç është paraparë në marrëveshjen e kontratës në rast kur puna nuk ka mbaruar me kohë, në përputhje me nenin 15 të kontratës 624 10 052 511, datë 2010/11/10 nënshkruar midis palëve : Komuna e Suharekës dhe të kontraktuesit "Control Produkt Sh.p.k Prishtinë. Pagesa paradhënie e kryer nuk ishte në përputhje me nenin 38 të Ligjit 03L-048.

Risku

Mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimet nga autoritetet ose dokumentacioni i pakompletuar në dosjet e prokurimit mund të shpie në mos-pajtim me Ligjet ose kërkesat e kontratës dhe deri në humbje të rëndësishme.

Për më tepër, mos zbatimi i interesit të gjobës sipas marrëveshjes në kontratë rezultojnë në humbje të të hyrave. Për më tepër, pagesa e kontraktuesit para të fillimit të punës të projektit paraqet rrezik të lartë për organizatat e fondeve buxhetore publike, sepse ajo mund të rezultojë në humbjet te fondeve të transferuara te kontraktori edhe pse ka garanci të vlefshme për shumën totale.

31 Ddhjetor 2010

Rekomandimi

Komuna duhet të krijoj procedura të duhura të kontrollit për monitorim efektiv mbi përputhshmërinë me ligjet e zbatueshme dhe rregulloret. Ne e këshillojmë kryetarin të sigurojë që Komuna të zbatojë siç duhet termet dhe kushtet e kontraktuara dhe të zbatojë dënimet atëherë kur kontraktuesi nuk përfundon në kohë projektin. Kjo zbatohet veçanërisht kur kërkesa për të zgjatur afatin kohor para se të skadojë siç është përcaktuar në kontratë, nuk është paraqitur.

Komentet e Menaxhmentit

1. Kontrata furnizim me karburante për automjete dhe gjenerator me numër të prokurimit 624.08.107-121 të cilës i ka skaduar afati me 28 janar 2010 , ju njoftojmë se kësaj kontrate i është vazhduar afat me datën e skadimit deri në zgjedhjen e operatorit deri pasi që lënda ishte në procedurë , ku si dëshmi po u sjellim Vendimin e Kryetarit si dhe vazhdimin e kontratës kopje .
2. Rregullimi i shtratit te lumit Toplluha faza e dytë me nr të prokurimit 624.10.052.521 Sipas organit mbikëqyrës punimet kanë filluar por për shkaqe të kushteve atmosferike dhe precizitetit të kryerjes se punëve dhe pamundësisë së vazhdimit të punimeve është kërkuar të ndërpriten punimet .
3. Paga është bërë në tërsi nga ana e autoritetit kontraktues, dhe kontrata është siguruar për një mos dëmtim substancial me instrument të sigurisë nga një kompani e sigurimeve e licencuar me afate të vlefshmërisë deri me 17,12,2011 .Punimet kanë filluar me intensitet.

Këtij komenti po ju bashkangjesim

1. Raportin e menaxherit te projektit dhe .Orgganit mbikëqyrës
2. Sigurimin e ekzekutimit te kontratesdhe
- 3 . Aktvendimin e kryetarit lidhur me ketë kontratë

Verejtje:Data ne vazhdimin e kontrates 28.01.2009 eshte leshuar nje gabim teknik per deri sa duhet te jete 28.01.2010 shih edhe datën e kontratës bazë së cilës i skadaon afati me 28.01.2010.

Vazhdimet e të gjeturave të vitit të kaluar

Gjetjet e vitit të kaluar

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Burimi parësor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Edhe pse Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në një program lokal me baze në Access ky sistem nuk përdoret për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare

Megjithëse kryetari e kishte nënshkruar Deklaratën lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, komuna nuk kishte përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhë serbe. Megjithatë, Komuna nuk ishte në gjendje të japë një version përfundimtar të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.

Përveç kësaj, informacioni i mëposhtme i cili është i nevojshëm për tu shpalosur në pasqyrat financiare nuk është regjistruar në Free Bilanc dhe nuk është pjesë e programi kontabilitetit të integruar:

- Prona Impiantet dhe Pajisjet,
- Faturat e pa paguara (detyrimet)
- Pagesat nga palët e treta

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente

Si rrjedhojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Në deklaratimet e financiare të komunës së deklaratave, shënim 12,1 "të hyrat vetanake- Të Ardhurat nga Taksat Administrative shënim, 12,1 nuk ishte përfunduar. Megjithatë, detajet e kërkuara në shënimin 12,1 u dhanë në shënimin 12.

Risku

Dobësitë në kontrollet e brendshme lidhur me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe keqpohimeve lidhur me sa vijon:

- Plotësinë dhe saktësinë e informatave financiare;
- Integritetin e të dhënave;
- Mbrojtjen e Aseteve dhe;
- Mos-regjistrimin e pagesave nga palët e treta mund të rezultojnë në mjete / shërbime të tilla duke u përdorur me pa qira nga palët e tjera prej Komunës.

Vazhdimet e të gjeturave të vitit të kaluar

Rekomandim

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshijë procedurë dhe metoda të cilat janë dizenuar për të siguruar që informacioni i kërkuar të jetë regjistruar, procesuar dhe përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshatëshme në pasqyrat financiare

2 Menaxhimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve

Të gjeturat

Komuna mban regjistër të veçantë me të dhënat financiare për pasuritë e saj fikse. Megjithatë, bazuar në ekzaminimin tonë, ne kemi gjetur se të dhënat lidhur me pasqyrat financiare të Komunës deri më 31 Dhjetor 2009 nuk janë rakorduar me ato prej regjistrimit të aseteve fikse mbahet në sistemin informativ të menaxhimit financiar në Kosovë (FMISK). Kjo është për shkak të faktit se për shkak se Thesari ka aplikuar zhvlerësimin në përputhje me metodat e amortizimit, por komuna nuk ka aplikuar zhvlerësimin në regjistrin e saj kjo nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit administrativ Nr.21/2009 mbi Menaxhimin e pronës së qeverisë neni 4 pika 6.1-6.14.

Për më tepër, Komuna ka matur artikujt e aseteve të saj, ndërtesat dhe pajisjet me vlerën e drejt, përcaktohen në bazë të vlerësimit të kryer gjatë vitit 2009. Vlerësimi është bërë nga një komision i themeluar nga brenda. Komiteti nuk është e përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë mbështetur nga ndonjë raport vlerësimi.

Për shkak të çështjeve të diskutuara më lartë, ne nuk ishim në gjendje për të marrë siguri të arsyeshme për saktësinë e të dhënave financiare në lidhje me asetet fikse të Komunës të shpalosura në pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2009.

Risku

Mos ekzistenca e procedurave dhe politikave të regjistrimit adekuat mund të shpie tek trajtimi jo adekuat i asetit në sajë të kufizimeve të pandara të kontrollit të ambientit.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë Komunën e Suharekës të zhvillojë dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet. Përveç kësaj dhe si minimum, për regjistrimit të lartpërmendur duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për çdo pasuri fikse:

- a. Datën e përvetësimit
- b. Vendndodhjen
- c. Numër i specifikuar nga komuna (numër identifikues)
- d. Numër serik
- e. Përshkrimi dhe funksioni
- f. Kosto
- g. Detajet e zhvlerësimit, duke përfshirë metodat e llogaritjes si për qëllime të taksave edhe financiare për qëllime të raportimit
- h. Jeta e dobishme e parashikuar
- i. Koston e mirëmbajtjes pas datës së përvetësimit
- j. Data e nxjerrjes jashtë përdorimit
- k. Burimi i Financimit
- l. Numri i faturës së përshpenzimit e bërë

Vazhdimet e të gjeturave të vitit të kaluar

3 Të Hyrat

Të gjeturat

Një sistem i automatizuar faturimit ekziston vetëm për tatimin mbi pronën. Me përjashtim të të ardhurave nga licenca e biznesit i cili është mbajtur në regjistrimet në Access, faturimi i Komunës është regjistruar në një sistem jo të automatizuar të faturimit

Risku

Përderisa të arkëtueshmet nuk janë kërkuar të shpalosen në pasqyrat financiare, mungesa e saktësisë dhe tërësisë do të ndikojnë në të hyrat që Komuna mund të fitojë. Kontrollat e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe papërshtatshmëria softuerike dhe sistemi i faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të informacionit. Dobësitë e tilla të sistemit mund të çojnë në faturim jo të plotë dhe të ardhura jo të plota. Regjistrimi manual dhe mungesa e ndërhyrjes së faturimit dhe sistemi i kontabilitetit ekspozon Komunën për rrezikun shtesë të gabimeve. Përveç kësaj, ajo mund të jetë konsumim i kohës dhe mund të krijojë shpenzime shtesë për regjistrin e të dhënave, rishikimin dhe harmonizimin e informacionit.

Rekomandim

Ne rekomandojmë që Komuna të përmbaj regjistër të ndarë të debitorëve të saj. Ky informacion mund të përmirësonte dukshëm menaxhimin e të hyrave gjatë Procesit të buxhetimit dhe mbledhjes së asetëve. Menaxhmentit gjithashtu do të përfitonte duke zbatuar procesin e faturimit dhe mbledhjes së informacionit në baza të kohës reale. Lista e detajuar dhe e rifreskuar e tatimpaguesve individual, bizneseve aktive dhe debitorëve të nxjerrur nga sistemi është e rëndësishme sidomos në situatën aktuale ku komunat nuk regjistrojnë secilin transaksion individual në Free Balance.

4 Shpenzimet

Gjetjet

Bazuar në ekzaminimin tonë të dëshmimeve burimore për fatura dhe pagesa për mjekime dhe printime të materialit ne kemi gjetur disa raste ku shënimet e faturave të mallrave nuk janë nënshkruar nga personi që I ka pranuar ato në drejtorinë e Shëndetësisë – kujdesi fillestar.

Risku

Zbatimi jo i duhur i kontrolleve të themeluara mund të shpie deri te keqpërdorimi i asetëve të Komunës dhe mund të ketë ndikim negativ në kompletimin dhe përpikërinë e informacionit financiar të Komunës.

Rekomandim

Ne këshillojmë komunën që në mënyrë strikte të zbatojë kontrollet e krijuara p.sh. gjithë dokumentacionin burimor lidhur me faturat e mallrave do duhej autorizuar nga personi që ka pranuar mallrat.

Komentet e Menaxhmentit

Mostrat e ekzaminuara nga ana e auditorët janë të kompletuara ne pajtueshmëri me rregullin financiar nr 02 mars te vitit 2009 dhe ne origjinal te dosjeve ekzistojnë te gjitha nënshkrimet e autorizuesve dhe zyrtarit për pranim këtë ia kemi dokumentuar edhe auditorit raportet e pranimit ne origjinal. I gjithë dokumentacioni ne origjinal ruhet dhe arkivohet ne thesar për deri sa dokumentacioni tjetër fotokopjet dhe ruhet nga programet buxhetore ne fotokopje .dhe gjatë fotokopjimeve ka mundësitë rrjedhe qe mos te shikohet edhe ndonjë nënshkrim eventual,

Vazhdimet e të gjeturave të vitit të kaluar

Ju bëjmë me dije se asnjë pagese nuk mundte të autorizohet dhe certifikohet për deri sa dosja ne original nuk është e kompletuar dhe e konfirmuar nga autorizueset dhe zyrtari i pranimit.

Shtojce dokumentacioni i pagesave përkatësisht raportet e pranimit te nënshkruar nga zyrtari i pranimit

4 Prokurimi

Të gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor në lidhje me procedurën e tenderit të aplikuar për ndërtimin e rrugëve, riparimin e shtresës së lumit, furnizimin me karburant, ndërtimit etj shkolla, ne kemi identifikuar parregullsi të caktuara.

Konkretisht, në ndërtimin e rrugës Skënderbeu faza e III me ID no.624 09 038 521 ka pasur një vonesë të përfundimit të punës, dhe Komuna nuk ka marrë informacion për vonesën. Gjithashtu Komuna nuk e ka aplikuar dënime siç është parashikuar në marrëveshje e kontratës në rast kur puna nuk është përfunduar me kohë.

Më tej, në ndërtimin e shkollës me ID nr. 624 09 013 521 kishte dy muaj vonesë për të përfunduar punën, dhe komuna nuk ka marrë informacion për vonesën. Gjithashtu Komuna nuk e ka aplikuar dënime siç është parashikuar në marrëveshje e kontratës në rast kur puna nuk ka mbaruar me kohë.

